



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Inspeksionit
Periudha Raportuese	Maj, 2019
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Adelina Ademi

1. PËRMBLEDHJE

Gjatë muajit maj 2019, mbarëvajtja e punëve ishte në nivelin e duhur, me përjashtime të emergjencave eventuale të paparashikuara, si dhe dinamikës së punës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

- Organizimi dhe koordinimi i punëve brenda sektorit;
- Ndarjen e punëve dhe detyrate të punës, si dhe kujdesi për angazhimin e plotë të punëtorëve brenda sektorit;
- Njoftimi me udhëzime dhe urdhëresa lidhur me punën në kuadër të sektorit;
- Mbikëqyrja për kryerjen e rregullt të punëve, në përputhje me ligjin dhe aktet tjera në fuqi;
- Përcjellja e gjendjes në kuadër të sektorëve, identifikimi i problemeve dhe vështirësive, si dhe propozimi i masave për mënjanimin e tyre;
- Përgatitja e planeve dhe raporteve ditore, javore dhe mujore të punës;
- Monitorimi i deponive ilegale në territorin e Prishtinës;
- Vizita nëpër objekte, për të cilat kemi pasur njohuri se nuk i zbatojnë rregullat, si dhe vërejtjet paraprake ambientale;
- Inspektim të transportit publik;

- Inspektim të lokaleve afariste sa i përket kushteve sanitare dhe tejkalimit të orarit të punës;
- Inspektim të lokaleve afariste në lidhje me çështjen për konsumim të duhanit brenda ambienteve ku është e ndaluar pirja etj.;
- Mbledhja e taksës komunale për shfrytëzim të hapësirës publike etj.;
- Aksione në vazhdimësi në transportin publik;
- Aksione në vazhdimësi për shitës ambulantë;
- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Inspektim final i objekteve ndërtimore;
- Rrënim i objekteve pa leje.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Ndërtimi:

- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Rrënim i objekteve pa leje;
- Fletëthirrje – 83;
- Procesverbale – 85;
- Aktvendime për ndërprerje të punëve – 0;
- Aktvendime për rrënim – 1;
- Aktvendime për kthim në gjendje të mëparshme – 3;
- Aktvendime të ekzekutuara – 1;
- Gjoba mandatorë – 10;
- Gjithsej, shuma e përgjithshme e gjobave - 2.900 €;
- Gjoba te paguara – 2, me shumën prej 600 €;
- Gjithsej, shuma e përgjithshme e gjobave të pa paguara – 8, me shumën prej 2.300 €.

Pylltaria:

- Konfiskimi **11.85m³** dru;
- Kërkesa (të rregullta dhe renovime) për prerje në pyje private janë

(renovime) – 18 (të kompletuara - 57, të pakompletuara - 12), gjithsej 87 copë;

- Fletëparaqitje për kundërvajtje - 8;
- Fletëparaqitje penale – 4.

Rendi komunal:

- Lëndë të pranuara – 254;
- Procesverbale – 124;
- Lëndë të iniciuara për gjykate – 3;
- Ankesa -24;
- Kërkesa – 37;
- Kërkesa për asgjësim të mallit – 3;
- Dëmtim për gypin e ujësjellësit – 3;
- Gropim dhe dëmtim i rrugëve dhe hapësirës publike – 9;
- Inspektim-mbikëqyrje higjieno-sanitare, pajisja me pëlqim sanitari – 7;
- Pëlqime sanitare – 32;
- Inspektim i produkteve ushqimore, afatet e përdorimit – 2;
- Konstatime – 9;
- Mosrespektim i rendit të udhëtimit – 2;
- Dëmtim i hapësirës publike të gjelbëruara – 14;
- Rrjedhje uji – 4;
- Shfrytëzim i hapësirës publike pa leje përkatëse – 19;
- Eksposizim i mallit – shitës ambulant – 5;
- Taksi pa leje pune – 24;
- Gjoba mandatore – 67;
- Gjoba mandatore për ndotje të mjedisit – 13;
- Plane operative në transport publik dhe shitësve ambulantë në vazhdimësi;
- Kërkesa nga GJTHDK për plotësim adresë – 19.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Sektori i pylltarisë:

- Hartimi i raporteve për muajin maj 2019 dhe dërgimi i tij Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- Llogaritja e fletëparaqitjeve, inicimi i procedurave gjyqësore dhe procedimi i tyre nëpër gjykata kompetente, si dhe kontaktimi me gjyqtarë për harmonizimin e dispozitave ligjore;
- Kontrollimi i terreneve pyjore dhe transportimi i masës drunore;

- Mbështetja dhe shpjegimi i procedurave për aplikim të marrjes së lejes për shfrytëzimin e pyjeve private;
- Pranimi i palëve e aktiviteteve tjera;
- Kontaktim dhe bashkëpunim me Drejtorinë Koordinuese të APK-ës (Planet e menaxhimit të pyjeve për vitin 2019 etj.

Sektori i Rendit komunal:

- Kontrolle dhe inspektime në terren në vazhdimësi nga ana e inspektorëve;
- Aksione në vazhdimësi në transportin publik dhe për shitës ambulantë;
- Inspektim të hapësirave publike;
- Inspektim – mbikëqyrje të bizneseve të ndryshme për plotësim të kushteve teknike higjieno – sanitare;
- Inspektim - mbikëqyrje të marketeve për produkte ushqimore pa afat.

Sektori i ndërtimit:

- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e ndërtimeve pa leje të evidentuara;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Rrënim i objekteve pa leje;
- Inspektimi final i objekteve ndërtimore.

5. STATISTIKAT

5.1.Takimet me palë

Të dhënat e mëposhtme janë relative:

- Sektori i ndërtimit – 149;
- Sektori i pylltarisë – 11;
- Sektori i Rendit komunal – 150;
- Kabineti i drejtore – 39.

5.2.Lëndët e pranuara, të kryera dhe në përfundim e sipër

Rendi komunal

- Lëndë të kryera – 18;
- Lëndë në procedurë – 197;
- Njoftime nga drejtore e tjera – 21;
- Kërkesa nga GJTHDK për plotësim adrese – 15;

- Pezullime nga gjykatat – 38;
- Hedhje poshtë nga gjykatat – 1;
- Dënlime nga gjykatat - 18;
- Fletëthirrje nga Gjykata Themelore në Prishtinë - 7 ;
- Aktvendim me të cilën është shpallur jo kompetent Gjykata Themelore - 3..

Sektori i Ndërtimit

- Ankesa – kërkesa të qytetarëve - 112;
- Kërkesa për inspektim final - 4;
- Të shqyrtaura – 42;
- Ankesa – kërkesa të pashqyrtaura (në procedurë) – 70;
- Lëndë në procedurë të lejes – 11;
- Me leje ndërtimi – 20.

Sektori i Pylltarisë

- Të hyrat nga pyjet private – 513.00 Euro;
- Të hyrat nga pyjet publike – 0 Euro;
- Kërkesa nga GJTHDK për plotësim adrese 5.

6. SFIDAT

- Mungesa e planeve rregulluese detyron qytetaret të tentojnë për ndërtime pa leje;
- Duke u mbështetur në raportimin e inspektorëve dhe diskutimet e shpeshta me ta për gjendjen në terren, kemi konstatuar se **shkeljet ligjore - ndërtimet informale**, shumë shpesh ndodhin edhe si pasojë e vonesës tonë (**INSTITUCIONEVE**), me për të ju prirë proceseve me planifikim. Ato - planet diku mungojnë e diku janë në s'përputhje me gjendjen faktike në terren dhe si të tillë vështirë të realizueshëm.
- Shumë shpesh qytetarët shprehen se kanë qenë dhe janë të gatshëm t'i nënshtrohen procedurave për t'u pajisur me leje përkatëse, por nga pamundësia për t'u pajisur me leje, në njëren anë, dhe nevojat e menjëershme për banim (rritja e familjes, shtimi i kurorave, kërkesa për banim më kualitativ etj.), i bën ata të zgjedhin zgjidhjen e menjëershme të banimit, qoftë edhe duke e shkelur ligjin.
- Shumë shpesh qytetarët deklarojnë se edhe për pasojë të problemeve pronësore (jo gjithmonë për faj të tyre), nuk mund t'i nënshtrohen procedurave për t'u pajisur me leje përkatëse.
- Prandaj, nga sa u tha më sipër, dhe duke konsideruar veten tonë (**INSTITUCIONET**) si shërbyes të qytetarëve, i propozojmë Zyrës ligjore të Komunës së Prishtinës të shqyrtojnë mundësitet ligjore për hartimin e ndonjë **rregulloreje** ose ndonjë **akti tjetër administrativ**, që qytetarëve me kërkesa të tilla dhe në situatat e përshkruara më lart, t'u

bëhet një **zgjidhje më e shpejtë** në ndërmjetkohën e prurjes së planeve të reja, revidimit të atyre ekzistuese dhe rregullimit të problemeve pronësore.

- Përvoja dhe praktika të tillë duhet të ketë, por edhe nëse nuk gjenden, Drejtoria e Inspeksionit - Sektori i ndërtimit, shpreh gjithë gatishmërinë për bashkëpunim me Zyrën ligjore dhe me cilindo institucion tjeter;
- Kërcënimet e vazhdueshme dhe sulmet ndaj stafit janë sfidë, për shkak se nuk ekziston mbështetje as shëndetësore, as financiare;
- Mungesa e stafit - numri shumë i vogël i inspektorëve, shkakton pamundësi të efikasitetit në punë për dy arsyet, e para, pamundësia e mbajtjes në kontroll të terrenit dhe identifikimi i lehtë i inspektorit dhe mbajtja në presion të vazhdueshëm;
- Mungesa e automjeteve;
- Mungesa e aparateve fotografike;
- Lejet e lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit krijojnë konfuzion për shkak të mos përcaktimit të kuotave vertikale të fundimit të objekteve;
- Në mungesë të Inspektorit komunal të autorizuar vetëm për banim në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit, sipas Ligjin nr.04/L-134, për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, ne nuk kemi arritur të zbatojmë këtë ligj dhe aktet nënligjore;
- Mënyra e shqyrtimit dhe trajtimit të objekteve me shkallë të lartë të rrezikshmërisë (objekte të banueshme dhe të pabanueshme), pas identifikimit nga inspektorët e ndërtimit gjatë kontrollit ditor, si dhe pas pranimit të kërkesave të shumta nga qytetarët që kemi pranuar në Drejtorinë e Inspeksionit;
- Mungesa e lokacionit – Tregut për shitjen e masës drunore;
- Mungesa e automjeteve për terren;
- Mungesa e lokacionit dhe hapësirës për vendosjen dhe sigurimin e druve te konfiskuara;
- Mungesë e rojeve të pylli për ruajtja dhe mbrojtjen e terrenit;
- Pamundësia dhe nevoja për hapjen e 2, eventualisht 3 vendeve të reja të punës për roje pylli;
- Prerësit ilegalë të pyjeve (recidivistë); të cilët janë të njohur për Policinë, Prokurorinë, dhe nuk merren masa adekuate për t'i parandaluar ata.

7. REKOMANDIME

- Rritja e numrit të inspektorëve;
- Automjete për inspektim tereni;
- Aparatet fotografike;
- Sigurimi i kushteve për punë në zyrë nga aspekti teknologjik (kompjuterë, printerë etj.);
- Pagesa për rrezikshmërinë;
- Sigurimi në rast fataliteti në punë;
- Furnizim me mjete dhe instrumente matëse.

8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

- Obligimi i bizneseve për t'u pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike;
- Largimi i deponive ilegale të mbeturinave;

- Largimi i mbeturinave inerte;
- Kontrollimi i sipërfaqeve të gjelbra publike;
- Mbikëqyrja e rrugëve rreth punishteve;
- Inspektim të transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave;
- Inspektim i lokaleve afariste, kushteve sanitare, varrosjen e kafshëve;
- Inspektim të dëmtimit të rrugëve;
- Inspektim të hapësirave publike etj.;
- Organizimi dhe koordinimi i punëve brenda sektorit;
- Ndarjen e punëve dhe detyrave të punës, si dhe kujdesi për angazhimin e plotë të punëtorëve brenda sektorit;
- Njoftimi me udhëzime dhe urdhëresa lidhur me punën në kuadër të sektorit;
- Mbikëqyrja për kryerjen e rregullt të punëve, në përputhje me ligjin dhe aktet tjera;
- Përcjellja e gjendjes në kuadër të sektorit, identifikimi i problemeve dhe vështirësive, si dhe propozimi i masave për mënjanimin e tyre;
- Përgatitja e planeve dhe raporteve javore, mujore dhe vjetore të punës;
- Inspektimi i lokaleve afariste sa i përket kushteve sanitare dhe tejkalimit të orarit të punës;
- mbledhja e taksës komunale për shfrytëzim të hapësirës publike etj.;
- Aksione në vazhdimësi në transportin publik;
- Aksione në vazhdimësi për shitës ambulantë;
- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Inspektimi final i objekteve ndërtimore;
- Rrënim i objekteve pa leje.